REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E NOVOBËRDËS - OPŠTINA NOVO BRDO
DALËSE - IZLAZNA
Nr/Br 01/53
Më/Dana 19.01.2024.
NOVOBËRDË - NOVOBRDO

# Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
## Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo

---

**KUVENDI KOMUNAL-SKUPSTINA OPSTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY**

---

**Anëtarit të Komitetit për Politikë dhe Financa**
Z/znj________________________________

**Në bazë të dispozitave te nenit 52 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale si dhe në bazë të dispozitave të nenit 41 të Statutit të Komunës së Novobërdës.**

**F T O J**

Mbledhjen e parë të Kuvendit Komunal, e cila do të mbahet më **31.01.2024** ( e mërkure) duke filluar ne ora **10:00.**

**R e n d i i d i t ë s**

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KK-se-së;
2. Shqyrtimi i planit orientues të punës të Kuvendit për vitin 2024;
3. Shqyrtimi i propozim orarit për mbajtjen e mbledhjeve të KPF-së dhe Kuvendit për vitin 2024;
4. Shqyrtimi i mundësive financiare (nga buxheti i Kuvendit) për kompletimin e Administratës së KK dhe Kuvendit, me mjete të nevojshme të Punës;
5. Pruarja e vendimit për mbushje telefonike për vitin 2024;
6. Plotsim ndryshim i aneks kontrates me Ekologjin.
7. Shyrtim dhe aprovim i ndryshimeve dhe plotsimeve të memorandumit të bashkpunimit të komunes dhe njesis vullnetare-Gjilan,per vezhdimin e kontrates per gjasht muaj:01.03.2024-31.10.2024,dhe rritjen e pagave.
8. Të ndryshme.

Mbledhja do të mbahet në hapësirat e K.K-së në Novobërdë.

**Më:19.01.2024**
**Në: Novobërdë**

**Kryesuese e Kuvendit**
**Mirjana Simijonovic**

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E NOVOBËRDËS - OPŠTINA NOVO BRDO
DALËSE - IZLAZNA
Nr/Br 01/56
Më/Dana 22.01.2024.
NOVOBËRDË - NOVOBRDO

Procesverbal K.K.

# Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosova
## Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo–Municipality of Novo Brdo

**ZYRA E KUVENDIT/KANCELARIJA SKUPŠTINE**

## PROCESVERBAL

Nga mbledhja e dymdhjet e Kuvendit të Komunës së Novobërdës e mbajtur më: 29.12.2023, me fillim nga ora 10:05.

Në mbledhje morën pjesë: Kryetarja e Kuvendit, znj. Mirjana Simijonoviq, nënkryetari i Kuvendit, z. Ramush Mehmeti, nënkryetar i Komunës për Komunitete z. Bajrush Ymeri, deputetë: Stojan Stanojeviq, Pranvera Kastrati Gashi, Negovan Jovanoviq, Milica Jovanoviq, Selatin Nuhiu, Dobrivoje Gjorgjeviq, Vlora Vllasaliu mungon Vlora na ka njoftu se ajo ka lindur femiun dhe është me arsye mungesa e saj,Abdyl Gashi,Ivana Ivanovic,Stefan Kovacevic dhe Dragana Dimic Ivica Ceniq, Violeta Milošević, përfaqësuesi i OSBE-së z. Edmond Hyseni, zyrtarë komunal dhe qytetarë.

Seancën e hapi kryesusja e Kuvendit, i cili përshëndeti të gjithë të pranishmit dhe tha: Konfirmoj që janë të pranishëm 14 deputetë, kemi kuorum për punë dhe vendimmarrje dhe me këtë fillojmë seancën:

### Rendi Ditës

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e K.K-së;
2. Informimi mbi realizimin e planit vjetor 2023, të Zyres Komunale të Prokurimit Publik;
3. Informimi mbi realizimin e planit vjetor 2023.të zyres Komunale të Auditorit të Mbrendshem;
4. Informimi nga Komisioni për Emrimin e Rrugeve në Teritorin e Komunes së Novobërdës, (e propozuar nga Komiteti i Komuniteteve);
5. Rishqyrtimi i problemit të Rruges Stanishor-Prekovc,dhe marrja e obligimit për sanimin urgjent të rruges se lartepermendur (e propozuar nga Komiteti i Komuniteteve)
6. Shqyrtimi mbi debatin publik që organizohet nga Kompanija "Agi-Dani" Gjilan, në bashkpunim me Ministrin e Ambijentit, Planifikimit Hapsinore dhe Infrastrukturës, si dhe Komunës (për të cilën komuna nuk është e informuar).
7. Të Ndryshme;

Kryesusja pyeti të pranishmit nëse janë dakord me këtë rend dite apo nëse kanë ndonjë sugjerim.
Drejtori i Bujqesis zt.Dragan Vasic pasi pershendeti të pranishmit kerkoj që te futet në rend dite dhe të bihet vendimi që mjetet e grumbulluara nga pagesa e 30% të fermerve per mjetet bujqesore të behet nje kod i ri dhe nga ky kod të behet prap pagesa per mjete bujqesore,ju faleminderit.
Kryesusja:Atëhere po e formulojm keshtu piken e shtat të rendit të dites:
**Prurja e Vendimit për bajtjen e mjeteve të grumbulluara nga perqindja e participimit të perfitusve nga projekti i ndarjeve së mekanizmit bujqesor.**
Kush është qe kjo pik të futet në rend dite të kesaj seance u lutemi ta ngreni doren per votim
Konstatoj se nga 14 antaret prezent me 13 vota pro dhe 1 kunder hynë ne rend dite pika e propozuar nga drejtori i Bujqesis.
Pra pika e shtat kalon ne piken e tetë të Ndryshme.
Kalojmë në piken e par të rendit të dites: **Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar** e K.K-së;

Procesverbal K.K.
E hapi diskutimin nese ka dikush nga koleget per te diskutuar, nese nuk ka atëhere kush është pro aprovimit të procesverbalit,
Konstatoj se nga 14 antaret prezent në sallë,13 votuan pro,ndersa nje antar nuk voton fare.
Kalojmë në piken e dytë te rendit të dites: **Informimi mbi realizimin e planit vjetor 2023, të Zyres Komunale të Prokurimit Publik.**
Fjalen ja jap menaxherit të Prekurimit zt.Fatos Ahmeti.

Pasi përshë Fatos Ahemti pasi pershendeti të pranishmit tha: ju falenderoj fillimishtë së pari për ftesën, në pika të shkrurtra po ju njoftoj me procedurat dhe realizimin e planifikimit, zyrja e prokurimit 15 ditë pas shpalljes së buxhetit në gazët zyrtare e kemi obligativ me dorëzu planin e prokurimit në AQP, plani i prokurimit është duhur të bëhet në bashkëpunim me drejtorit përkatëse ose më njësit kërkuese, kam probleme në këtë drejtim, unë zyrtarishtë cdo vitë kërkoj 1 muaj më herët se të planifikohet buxheti në mënyrë që të dorëzohet me kohë,unë planifikimin e bej vtem sa me nxanë nje afat ligjor,planifikimin e bej vetë porë nuk është nje planifikim i mirë dhe qdo here kamë pasur vrejtje nga auditori i mbrenshem se planifikimi nuk është i planifikuar mirë është vetem në vija te tresha por jo i detajum.

Unë po filloj me raportimin e ralizimit të planit,plani behet në tri faza në Furnizime,shpenzime dhe Punë,gjatë planifikimit ne bazohemi në buxhet ne vitin e kaluar sa janë planifikuar per shpenzime mund te them se mbi 60% janë shpenzuar,janë disa qeshtje teknike qe kanë mbetur si per shembull materjal higjenik se ka pas kontrat deri në shtator dhe per ket arsye nuk është shpenzuar 40%,por kemi pasur në depo materjal higjenik në depo dhe se nuk kemi pasur nevoj per te porositur.
Sa i perket sherbimeve qe i kemi planifiku ne kemi shpallur tenderin per mirmbajtjen dimrore të rrugve por ketu po kemi probleme se nuk po vin kompanit me apliku ,kemi pasur nje kompani qe ka aplikuar per tenderin e shpallur por me nje qmim shumë te lartë ku qmimi ka qen 10 mi kurse kompania ka aplikuar me 130mi,po edhe kompanit nga gjilani tani e kanë mesuar ketë por shpresoj se ne vitin e ardhshem do ti shti ne paket mirmbajtjen dimrore dhe pranverore dhe shpresoj se do te kemi kompani serjoze qe te aplikojn .
Sa i perket punve plani është ralizi 100%.deri në nenshkrimin e kontrates po flas se ketu kemi projekte qe janë duke u punuar .
Ndersa ne kapitale jemi vonuar pak pa deshiren tonë sepse kemi pasur ankesa ne hartimin e projekteve kapitale,ndersa ato projekte nuk guxojm mi shpall edhe pse ka ardhur se ne kemi pasur te drejt se janë vlersu drejt .pra mund te them se plani i punes është ralizuar në tersi 70%.ju faleminderit nese ka dikush ndonje pytje jam i hapur ,
Kryesusja,Ju faleminderit Fatos, tani e hapi diskutimin nese ka dikush urdheroni ,
Abdyl Gashi:ju pershendes të gjithve dhe nje herit e falenderoj Fatosin se është hera e parë qe po raportoni në kuvend por raporti ka mangesi të shumta raporti nuk është i perfunduar dhe nuk ceket cilat projekte janë te perfunduara e cilat janë ne perfundim e siper,
Fatos Ahmeti: Realisht të nderuar deputet disa projekte dhe vlerat e tyre i keni në Buxhet ju keni votuar një buxhet me emer të projektit dhe vleren e ti,pershembull asfaltimi i rrugve lokale ju thash e dhe me heret raporti perfundimtar dhe i detajuar do të ju vije kur të perfundon viti dhe atëhere unë do te pregaditi raportin per ministrin dhe nje kopje do të ju dergoj edhe juve aty e keni me vleren e kontrates dhe projektet e ralizuara.projektet qe janë ralizu brenda planifikimit ju i keni në buxhet ju faleminderit.
Kryesusja urdhero Kolega Selatin:
Selatin Nuhiu:pershendetje per të gjithë te pranishmit,është një raporti i mirë i menaxherit të prekurimit dhe mendoj se punon mirë unë e njo mirë menaxherin e prekurimit dhe se punon një kohë te gjat dhe ka nje eksprienc te gjat unë i kisha uru vetem suksese dhe punë te mbar.
Kryesusja:urdhero fatos .
Ju faleminderit per keto fjal te mira realisht puna e prekurimit matet me raportet e auditorit të pergjithshem dhe janë ba tri vitet të fundit qe nuk kemi marrur asnje rekomandim nga auditori i pergjithshem ju faleminderit.
Abdyl gashi unë me sa e di dhe sa e kuptoj ne sot e presim vitin e ri dhe e kuptoj kolegen tem per keto fjal miradije po nuk është bash qashtu siq po thua ti i nderuar koleg ju faleminderit.
Kryesusja nese nuk ka dikush të shtoj diqka atëhere kalojm në piken e tret të rendit të dites .
Pika e tret e rendit të dites: **Informimi mbi realizimin e planit vjetor 2023.të zyres Komunale të Auditorit të Mbrendshem.**
Fjalen ja japë Auditorit të mbrenshem zt.kujtim Arifi ,urdheroni zt.Arifi

Kujtim Arifi ju faleminderit kryesuse ju pershendes të gjihve anëtar të kuvendit njesia e auditimit gjatë perjudhes se vitit 2023 ka planifikuar 5 auditime dhe tani deri në fund te vitit ka ralizuar 5 auditime ,ne fillim vitin e ardhshem ne do te pregaditemi nje raport te detajuar ku do të ja dorzoj kryetarit dhe nje kopje do të ja dorzoj edhe juve në kuvend per mos me zgjatë shumë juve ju deshiroj një vitë te ri të mbar ju faleminderit.
Kryesusja Ju faleminderit zt.Arifi e hapi diskutimin nese ka dikush, nese nuk ka askush atëhere kalojm në piken e Katert të rendit të dites.**Pika e katert e rendit të dites: Informimi nga Komisioni për Emrimin e Rrugeve në Teritorin e Komunes së Novobërdës,(e propozuar nga Komiteti i Komuniteteve);**
Kryesusja kjo pikë është e propozuar nga komiteti per komunitete a kemi dikand per ta prezentu ketë pikë,siq shihet në sallë nuk është askush nga ekzekutivi ,atëhere po ja jap fjalen Selatin Nuhiut pasi ashtë edhe antar i komitetit të komuniteteve.
Selatin Nuhiu pershendetje edhe një here me iniciativen time ketë pik e kemi kerkuar në kuvend permes komitetit të komuniteteve dhe kemi kerkuar qe të vi komisioni dhe të raportoj në kuvend per punen qe e ka ba ose nuk ka ba hiq se jemi e vetmja komun qe nuk i kemi te emruara rruget në teritorin ton dhe unë me qense punoj edhe në pos po kemi shumë probleme me adresa pasi qe anjë rrug nuk asht e emruar unë i baj thirrje qe ky komision te kry punen e vetë qe i eshtë ngarkuar e nese nuk asht i aft qe ky komision ta kry punen ta shkarkojm dhe ta formojm nje komision te ri i cili do ta kishte kryer ketë punë ju faleminderit.
Kryesusja urdheroni kolege pranvera.
Pranvera Gashi Kastrati.pershendetje dhe nderimet e mija per te gjith ju te pranishmeve sa i perket komisionit të emrimit të rrugve unë jamë antare e komisionit,gjdo her gjdo mbledhje të kpf e kuvendit kamë kerku qe të punohet dhe unë jamë e gatshme qdo here me punu qe me i dhan fund ketyre dokurive dhe i emrojmë rruget i kerkoj kryetarit ta shty ketë proces perpara ju faleminderit.
Kryesusja urdheroni kolega Stanojevic
Stojan Stanojevic ju perdhendes të gjithve me duhet të kyqem ne ketë pik të rendit të dites e di se ka qenë koj pik ne kuvend para nje viti dhe e shtytem per mbledhjen e rradhes per arsye se nuk kishte ardhur askush nga komisioni,unë po degjoj nga koleget ta formojm nje komision te ri ne sa komisione i kemi formuar,ne kur kemi formuar komisionin per emrimin e rrugve me kujtohet kur patim than se duhet me u regjistru të gjitha rruget dhe nuk e kuptoj se sa i rendesishem është kjo punë me u kry e kjo pik u sjell neper kuvend dhe edhe sot e kesaj dite nuk ka ardhur askush te prezentoj per raportin se deri ku ka mrri komisioni me perfundimin e rrugve ju faleminderit.
Kryesusja Urdhero koleg.
Ivana Ivanovic pershendetje per të gjithë ju shumica e dini se jamë antare e re në kuvend dhe nuk kamë shumë eksprienc në punen e kuvendit por po du me than se ky ashtë nje problem shum serjoz qe kemi me komunen ton pasi nuk kemi emruar rruget në teritorin tonë dhe mendoj se po të ketë vullnet kjo punë kryhet per nje muaj por siq po shihet nuk ka vullnet per punë unë jamë e gatshme qe të ju ndihmoj në ketë qeshtje kaq kisha ju uroj festat e fund vitit ju faleminderit.
Kryesusja a ka dikush të diskutoj per ketë rend dite nese jo atëhere kalojm ne piken e pest te rendit të dites.
Pika e Pestë: **Rishqyrtimi i problemit të Rruges Stanishor-Prekovc,dhe marrja e obligimit për sanimin urgjent të rruges se lartepermendur (e propozuar nga Komiteti i Komuniteteve)**
Kryesusja: eshe kjo pikë është me miratimin e komitetit per komunitete a ka dikush te prezentoj ketë pikë urdhero zonja shefkije
Shefkije Mehmeti: ju faleminderit kryesuse ju pershendes të gjithve të pranishmeve në sallë.ne e dimë gjendjen e rruges Prekoc-Stanishor që është e mjerushme mirpo në vitin 2020 kjo rrug ka kaluar me ministrin e Infrastruktures materjalin ju kamë derguar të gjithve dhe e keni para vete ju e keni edhe kerkesen qe ju kemi drejtuar atyne qe ta asfltojn ketë rrug por qe nga ajo kohë e deri me tani nuk kemi marrur kurfar pergjegjje ju faleminderit.
Kryesusja ju faleminderit zonja shefkije e hapi diskutimin nese don dikush të diskutoj urdheroni kolega Stanojevic
Stojan Stanojevic,me duhet të inkuadrohem prap edhe pse nuk e pata njet të kyqem të gjitha piket e rendit të dites e kanë rendesin e vet por kjo pik është shumë e rendesishme dhe siq po shihet vetem po na sillet në rreth prap ne kuvend,tri apo kater senaca jemi marrur me ketë problem nuk kemi mundur te vim me nje mendim apo perfundim dhe kolegeja shefkija dhe me vjen mirë qe asht perseri ka derguar kerkesa në ministri.
Por nese kemi ndonje pergjegjeje per ket rrug nga ministria ju lutem naj prezentoni ju faleminderit.
Kryesusja nga ministria e infrastruktures dhe agjendioni per minjera dhe minerale ne emde nuk kemi marrur kurfar pergjegjje per vendimin eqe e kemi marrur apo edhe per asfaltimin e kesaj rruge, urdhero Ramush Mehmeti.
Ramush Mehmeti ju faleminderit kryesuse une nuk po di edhe me heret kamë debatu per keto tema por nuk po di a spo dojna me ditë a nuk po kuptojm ,unë edhe kur ka qen votimi per marrjen e licencave unë kamë then skemi te drejt

po ka qen kerkes e qytetarve dhe unë e kamë votuar pro edhe nje here po ju thwm organet e qeveris se republikes se kosoves marrin vendime per projektet rajonale si per autobana si per rrug si per ketë rrug qe nuk na kan vet fare,kjo rrug qe po diskutojm une kam njoftim te plot se prej viteve 80 ka qen rrug regjionale kurr ska qen rrug komunale dhe ne si kuvend nuk mujna me marr vendim me kthy rajonale ,ne si kuvend mujna me kerku me shkres nga drejtoria me rinovu ket rrugë e asgje me shum nuk mujmi me ba ju faleminderit.
Kryesusja hajde të votojm me kerkesen e kuvendit që ti drejtohemi ministris së infrastruktures per rinovimin e rruges, Kush ështshtë pro,konstatoj se nga 14 anteret prezent 14 votuan pro.
Kryesusja kalojm në piken e Gjasht te rendit të dites.
Pika e Gjashtë : **Shqyrtimi mbi debatin publik që organizohet nga Kompanija "Agi-Dani" Gjilan, në bashkpunim me Ministrin e Ambijentit, Planifikimit Hapsinore dhe Infrastrukturës, si dhe Komunës (për të cilën komuna nuk është e informuar).**
Kryesusja per ketë pik do të na njofton Drejtori i Administrates urdhero drejtor .
Drejtori i Administrates Boban Djokic ju faleminderit kryesuse ju pershendes të gjithve me daten 9.12.2023 rreth ores 10 kanë ardhur punëtoret e kompanis Agi dani me nje leter qe kan dashur ta ngjesin në deren e komunes ata vetem e kan ngjit dhe e kan ba foto dhe e kan hekur dhe janë kthy nje punëtor i joni e k B foto dhe ma ka treguar mua dhe unë pastaj kam bisedu me kryetarin e komunes se a asht ne dioni per ket organizim te debatit pasi po shkruan se ne organizim edhe te komunes per nje debat qe do te mbahet me 01.02.2024 në shkollen e fshatit pasjak ne ora 10 e gjitha do te kishte qenrregull sikur te kishin marr leje prej organeve kompetente ju faleminderit .
Kryesusja ju faleminderit drejtor edhe ne nje dit para komitetit per politik e financa e kemi marrur ket informacion se do te mbahet nje debat në fshatin pasjak qe nuk ka lidhje fsh,Pasjak fare me gurthyrsit ,ky debat do te mbahej në koretisht ose strazh ose edhe ne ndertesen e komunes do te ishte me mir,por pasi kompania ka vepruar pa dienin ton unë mendoj qe ky debat mos te mbahet fare ,
Flamur Uka udhëheqes i drejtoris se arsimit,kompania na është drejtuar me nje shkres per lirimin e nje klase në shkollen fillore Nushi Tefiku në pasjak dhe ne në bazë te kerkeses ju kemi lejuar klasen per te mbajtur debatin por realisht ne nuk e kemi ditur temen e diskutimit e cila nuk është cekur ne kerkes poe ketu para jush po ju them se ne atë klas qe ju kemi liruar per mbajtjen e debatit do ta anulojm dhe ai te bije kerkes te re në drejtorin e financave.ju faleminderit,Kryesusja kalojm në piken e shtat te rendit të dites
Pika e shtat: **Prurja e Vendimit për bajtjen e mjeteve të grumbulluara nga perqindja e participimit të perfitusve nga projekti i ndarjeve së mekanizmit bujqesor.**

Kryesusja hapi diskutimin per ket rend te dites urdheroni nese ka dikush te shtoj diqka pasi nuk pati diskutime atëhere e qes ne votim propozimin e drejtorit të bujqesis kush është pro,konstatoj se nga 14 antrar prezent 14 votuan pro dhe asnje kunder dhe prunen ketë:

**VENDIM**

**Miratohet Vendimit për bajtjen e mjeteve të grumbulluara nga perqindja e participimit të perfitusve nga projekti i ndarjeve së mekanizmit bujqesor.**

Duke qenë se nuk pati diskutime të tjera, Kryesuesi falënderoi të pranishmit për pjesëmarrjen e tyre.
Takimi ka përfunduar në orën 11:40.

**Sylejman Avdyli**
Procesmbajtes

**Mirjana Simjonovic**
Kryesuesja Kuvendit

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E NOVOBËRDËS - OPŠTINA NOVO BRDO
DALËSE - IZLAZNA
Nr/Br 01/49
Më/Dana 18.01.2024
NOVOBËRDË - NOVO BRDO

# Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosova
## Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo–Municipality of Novo Brdo

### ZYRA E KUVENDIT/KANCELARIJA SKUPSTINE

| | |
|---|---|
| DATË/A: | 15.01.2024 |
| PËR/ZA/TO: | Antarët e Kuvendit Komunal |
| NGA/OD/FROM: | Mirjana Simijonovic – Kryesuese e Kuvendit<br>Predsedavajuca Skupstine za godina 2024 |
| TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT: | Plani i punës së Kuvendit për vitin 2024 |

Në bazë të nenit 12 paragrafit 2 pika d), dhe nenit 40, paragrafi 1 dhe 2, pika d) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetqeverisje Lokale dhe në bazë të nenit 34 pika 5 të statutit të Komunës së Novobërdës nr.01-992.Kuvendi i Komunes së Novoberdës propozon këtë:

**Plani orientuesi punës së Kuvendit të Komunës së Novobërdës për vitin 2024**

| | |
|---|---|
| JANUAR | Raporti i Punës së Kuvendit për vitin 2023 |
| | Informatë e Kryetarit mbi planin e Punës së Ekzekutivit per vitin 2023 |
| | Raporti Financiar për vitin 2023. nga drejtoria e financave |
| | Shqyrtimi i propozimi-vendimeve dhe kerkesave nga ekzekutivi komunal |
| | Shqyrtimi i mundësive financjare(nga bugjeti i Kuvendit)për kompletimin e administrates së K.K.me mjete të nevojshme të punes si dhe mirëmbajtjen e mjeteve ekzistuse |
| SHKURT | Shqyrtimi i propozimi-vendimeve dhe kerkesave nga ekzekutivi komunal |
| | Informatë mbi perfundimin e gjysëmvjetorit të parë shkollor dhe pregaditjet per fillimin e gjysmëvjetorit të dytë shkollor. |
| | Raportimi i Drejtoris së SH.P për sezonen dimrore gjendja e rrugve dhe mirëmbajtja. |
| | Shqyrtimi i Kerkesave të komiteteve ekzistuse. |
| | Raporti vjetor i kompanis Ekologjia per vitin 2023. |
| MARS | Bartja e të hyrave vetanake nga viti 2023 në vitin 2024 |
| | Shqyrtimi i propozimi-vendimeve dhe kerkesave nga ekzekutivi komunal |
| | Informim nga D.SH.P rrethë gjendjes së rrugve në sezonen Dimrore |
| | Shqyrtimi i Kerkesave të komiteteve ekzistuse. |
| | Aktivitetet rredhë dites së 8 marsit |
| | |

| | |
|---|---|
| PRILL | Raporti Financiar i tre mujorit të parë të vitit 2024 |
| | Shqyrtimi i propozimi-vendimeve dhe kerkesave nga ekzekutivi komunal |
| | Raportim nga kompania Ekologjia për mbarvajtjen e punve në teren |
| | Shqyrtimi i Kerkesave të komiteteve ekzistuse. |
| | shqyrtimi i qështjeve Aktuale-jashtzakonshme. |
| MAJ | Planifikimi dhe mbajtja e takimeve të Kuvendit me qytetaret e Komunes së Novobërdës për propozim buxhetin e vitit 2025-27 |
| | Raportimi i Drejtoris së bujqësis per mbjelljen pranverore. |
| | Shqyrtimi i propozimi-vendimeve dhe kerkesave nga ekzekutivi komunal |
| | Shqyrtimi i Kerkesave të komiteteve ekzistuse. |
| | Informatë mbi Qarkoren e parë buxhetore të Ministris së Financave |
| QESHOR | Shqyrtimi i propozimi-vendimeve dhe kerkesave nga ekzekutivi komunal |
| | Rishikimi i buxhetit të komunes për vitin 2024 |
| | Miratimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore për vitin 2025 -27 |
| | Informatë mbi ralizimin e Planit të Prekurimit |
| | |
| KORRIK | Raporti Financiar tre mujorit të dytë per vitin 2024 |
| | Shqyrtimi i Raportit të Auditimit të përgjithshëm për Komun per vitin 2023 |
| | Informat mbi përfundimin e Vitit shkollor |
| | Informat dhe raportim mbi suksesin e nxenësve |
| | Shqyrtimi i propozimi-vendimeve dhe kerkesave nga ekzekutivi komunal |
| GUSHT | Informat mbi përfundimin e fushates se korrje-shirjeve |
| | Informatë mbi Qarkoren e dytë buxhetore të MF-së |
| | Shqyrtimi i propozimi-vendimeve dhe kerkesave nga ekzekutivi komunal |
| | |
| | |
| SHTATOR | Shqyrtimi dhe miratimi i Buxhetit të Komunes për vitin 2025-27 |
| | Informatë mbi fillimin e vitit të ri shkollor |
| | Shqyrtimi dhe miratimi i Rregullores për tatimin në pronë |
| | Shqyrtimi dhe miratimi i regullores për taksa Komunale |
| | Shqyrtimi i propozimi-vendimeve dhe kerkesave nga ekzekutivi komunal |
| TETOR | Raporti Financiar tre mujorit të tretë per vitin 2024 |
| | Shqyrtimi i propozimi-vendimeve dhe kerkesave nga ekzekutivi komunal |
| | |
| | |
| | |
| NËNTOR | Informatë e Drejtorit për Shendetsi dhe Mirëqenje Socjale per ofrimin e shërbimeve primare shendetsore dhe rastet socjale. |
| | Shqyrtimi i propozimi-vendimeve dhe kerkesave nga ekzekutivi komunal |
| | Informatë e Drejtorit të Bujqësis,Pylltaris dhe Zhvillim Rural mbi të mjellurat e vitit 2024 |
| | Informat e Drejtorit të Zhvillimit Ekonomik mbi zhvillimet ekonomike në Komunë |
| | |

| | |
|---|---|
| DHJETOR | Informat mbi Planin Vjetor të Prekurimit Publik |
| | Informatë mbi Planin vjetor të Auditorit të Brenshem per vitin 2024 |
| | Indormat e Drejtorit per Kulturen,Rinin dhe Sportin në Komunë. |
| | Raport i Komiteteve para Kuvendit të Komunes. |
| | Shqyrtimi i raportit rreth aktiviteteve të KKSB-së |

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E NOVOBËRDËS - OPŠTINA NOVO BRDO
DALËSE - IZLAZNA
Nr/Br: 01/50
Më/Dana: 18.01.2024.
NOVOBËRDË - NOVOBRDO

# Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
**Komuna e Novobërdës**
Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo

**KUVENDI KOMUNAL-SKUPSTINA OPSTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY**

| | |
|---|---|
| **DATË/A:** | 12.01.2024 |
| **PËR/ZA/TO:** | Antarët e Kuvendit Komunal |
| **NGA/OD/FROM:** | Mirjana Simijonovic – Kryesuese e Kuvendit |
| **TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:** | Propozimi i orarit të mbajtjes së mbledhjeve të Kuvendit Komunal për vitin 2024 |

Të nderuar,

Në bazë të nenit 43.6 të Statutit po ju dërgoj orarin e mbajtjes së mbledhjeve të Kuvendit të Komunës për vitin 2024.

| **Nr** | **Dita** | **Data** | **Koha** | **Vendi** |
|---|---|---|---|---|
| 1. | E mërkurë | 31.01.2024 | 10:00 | Salla e Kuvendit Komunal |
| 2. | E enjte | 29.02.2024 | 10:00 | Salla e Kuvendit Komunal |
| 3. | E enjte | 28.03.2024 | 10:00 | Salla e Kuvendit Komunal |
| 4. | E martë | 30.04.2024 | 10:00 | Salla e Kuvendit Komunal |
| 5. | E enjte | 30.05.2024 | 10:00 | Salla e Kuvendit Komunal |
| 6. | E enjte | 27.06.2024 | 10:00 | Salla e Kuvendit Komunal |
| 7. | E mërkurë | 31.07.2024 | 10:00 | Salla e Kuvendit Komunal |
| 8. | E enjte | 05.09.2024 | 10:00 | Salla e Kuvendit Komunal |
| 9. | E hënë | 30.09.2024 | 10:00 | Salla e Kuvendit Komunal |
| 10. | E enjte | 31.10.2024 | 10:00 | Salla e Kuvendit Komunal |
| 11. | E mërkurë | 27.11.2024 | 10:00 | Salla e Kuvendit Komunal |
| 12. | E hënë | 30.12.2024 | 10:00 | Salla e Kuvendit Komunal |

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E NOVOBËRDËS - OPŠTINA NOVO BRDO
DALËSE - IZLAZNA
Nr/Br: 01/51
Dt/Dana: 18.01.2024
NOVOBËRDË - NOVO BRDO

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova - Republic of Kosova
**Komuna e Novobërdës**
Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo

---

**KUVENDI KOMUNAL-SKUPSTINA OPSTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY**

---

| | |
|---|---|
| **DATË/A:** | 12.01.2024 |
| **PËR/ZA/TO:** | Antarët e KPF-së |
| **NGA/OD/FROM:** | Mirjana Simijonovic – Kryesuese e Kuvendit |
| **TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:** | Propozimi i orarit të mbajtjes së mbledhjeve të KPF-së për vitin 2024 |

Të nderuar,

Në bazë të nenit 43.6 të Statutit po ju dërgoj orarin e mbajtjes së mbledhjeve të Komitetit për Politik dhe Financa për vitin 2024.

| **Nr** | **Dita** | **Data** | **Koha** | **Vendi** |
|---|---|---|---|---|
| 1. | E martë | 23.01.2024 | 10:00 | Salla e Kuvendit Komunal |
| 2. | E martë | 20.02.2024 | 10:00 | Salla e Kuvendit Komunal |
| 3. | E martë | 19.03.2024 | 10:00 | Salla e Kuvendit Komunal |
| 4. | E hënë | 22.04.2024 | 10:00 | Salla e Kuvendit Komunal |
| 5. | E martë | 21.05.2024 | 10:00 | Salla e Kuvendit Komunal |
| 6. | E martë | 18.06.2024 | 10:00 | Salla e Kuvendit Komunal |
| 7. | E martë | 23.07.2024 | 10:00 | Salla e Kuvendit Komunal |
| 8. | E mërkurë | 28.08.2024 | 10:00 | Salla e Kuvendit Komunal |
| 9. | E hënë | 23.09.2024 | 10:00 | Salla e Kuvendit Komunal |
| 10. | E martë | 22.10.2024 | 10:00 | Salla e Kuvendit Komunal |
| 11. | E hënë | 18.11.2024 | 10:00 | Salla e Kuvendit Komunal |
| 12. | E enjte | 19.12.2024 | 10:00 | Salla e Kuvendit Komunal |

# Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosova
# Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo–Municipality of Novo Brdo

**ZYRA E KRYETARIT-KANCELARIJA GRADONACELNIKA**

Në bazë të dispozitave të nenit 58 germa ( g) dhe (h) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës nr.03/L-040 (GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS/ PRISHTINË: VITI V / Nr. 72 / 25 QERSHOR 2010) dhe nenit 57, të Statutit të Komunës së Novobërdës,Kryetari i Komunes i propozon kuvendit këtë:

## Memorandum Mirëkuptimi
## Në mes të

1. Komunes se Novobërdës e përfaqësuar nga z. Sasha Milloshevíq, kryetar i komunës së Novobërdës dhe
2. Shoqata e Zjarrfikësve Vullnetarë në Gjilan (në tekstin e mëtejmë SHZV), e përfaqësuar nga z. Elmi Kerimi, kryetar i Shoqatës nga ana tjetër..

**Qellimi**
**Neni 1.**

Qëllimi i këtij Memorandumi të Mirëkuptimit është ralizimin e projektit "Mbrojtja nga zjarri", me qëllim mbrojtjen e jetës së njerëzve dhe të mirave materiale nga zjarri, fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera.

**Roli dhe përgjegjësitë e palëve**
**Neni 2.**

Palët në këtë marrëveshje kanë rënë dakord si më poshtë:

1. Për zbatimin e kësaj marrëveshjeje nga neni 1, SHZV ofron 32 (njëzet e dy) anëtarë të Shoqatës në rolin e zjarrfikësve, të cilët do të punojnë në shërbim të Komunës së Novobërdës, gjegjësisht në Drejtorinë për Mbrojtje dhe Njësia e Shpëtimit - Zjarrfikësve, nga **01.03.2024** deri në **31.08.2024.** Nga kjo përbërje 28 (njëzet) janë zjarrfikës, dhe 4: shofer, dhe një mekanik;(i cili njëkosisht janë edhe zjarrfiks)
2. Kompensimi për 22 anëtarë vullnetarë të angazhuar do të jetë 344.56 euro (bruto) për një vullnetar në muaj dhe këto mjete do të paguhen nga buxheti i Komunës;
3. Komuna transferon burimet financiare për kompensim në xhirollogarinë numër SHZV **1302271200021749** të Bankës Private të Biznesit;
4. SHZV do t'i kalojë fondet e marra në llogarinë e anëtarëve vullnetarë të zjarrfikësve, të cilët janë të angazhuar në kuadër të këtij projekti, pasi kërkesa për pagesë të konfirmohet nga Kryetari i Komunes;

5. SHZV do të lidhë kontrata të veçanta me zjarrfikësit vullnetarë për pagesën e fondeve, duke respektuar dispozitat e ligjit në fuqi;

6. Në emër të punëve administrative dhe juridike, në ofrimin e ketyre shërbimeve që është objekt i kësaj kontrate, Komuna do të kompensojë SHZV-në në Gjilan në shumën prej 350.00 ( tridhjet e pes) euro në muaj, deri në kohëzgjatjen e kontratës.me: 31.08.2024

**Neni 3.**

Pjesë e kësaj Marrëveshjeje do të jetë projekti i pranuar dhe nënshkruar nga palët, lista e anëtarëve vullnetarë dhe dokumentacioni tjetër i nevojshëm i kërkuar nga Administrata Komunale.

**Neni 4.**

Palet Kontraktuse të Marveshjes së Mirëkuptimit,mund ta nderprejnë këtë Marveshje pas konsultimit të të dyave palve nenshkruse,edhe ate në raste të poshtëcekur:

- Në rast se MPB-ja dhe MF-ve,aprovojnë propozimin tonë (K.K.Novobërdë)për rritjen e numrit ekzistus të zjarrfiksve sipas ligjeve në fuqi;
- Nese Realizimi i të hyrave vetanake nuk shkon sipas planifikimeve tona buxhetore per të hyrat vetanake muaj pas muaji gjat vitit 2023.si dhe
- Dhe në rastet e tjera të parapara me ligjë.

ARSYTIM:Nderprerja e kesaj marveshje ralizohet pasi që palet e njoftojnë palen tjeter 30(Tidhjet) ditë kalendarik para se nderprerja te aplikohet (duhet të njoftohen palet nenshkruse dhe zjarrfiksit e angazhuar me shkrim per nderprerje).

**Neni 5.**

Në rast të mos respektimit të dispozitave të kësaj marrëveshjeje, palët do të marrin përsipër zgjidhjen e kontesteve, e në rast se kjo nuk arrihet, kompetente është Gjykata Themelore në Gjilan.

**Neni 6.**

Kjo Marrëveshje është nënshkruar në katër (4) kopje identike, ku secila palë do të marrë nga dy kopje.

Në Novobërdë
Me:________________

| | |
|---|---|
| Kryetar i Komunës së Novobërdës | Kryetar i SHZV |
| ________________ | ________________ |
| Sasa Milosevic | Elmi Kerimi |

JKP EKOLOGIJA D.D.

Opština Novo Brdo

Komuna e Novobërdës

Municipality of Novo Brdo

# ANNEX

## Për ofrimin e shërbimeve

## Nr. 02-736 od 01.03.2023.,

Në mes

1. KOMUNA E NOVOBËRDËS, përfaqësuar nga Sasha Milloseviq, kryetar i komunës (në tekstin e mëtejmë: Komuna)

2. NDËRMARRJA PUBLIKE "EKOLOGIJA" D.D. GRAÇANICA, përfaqësuar nga CEO Dejan Dimitrijević (në tekstin e mëtejmë: "Kompania")

i referohet ndryshimeve të mëposhtme:

**Neni 1**

Palët kontraktuese bashkërisht deklarojnë se kanë lidhur Marrëveshjen për ofrimin e shërbimeve Nr. 02/736 datë 01.03.2023, Aneks Marrëveshjen datë 02.05.2023, Aneks Marrëveshjen nr. 02/01 datë 03.01.2024.

**Neni 2**

Me këtë aneks të marrëveshjes së bashkëpunimit, palët kontraktuese ndryshojnë kl. 2 që lexon:
2.2. Kjo Marrëveshje Shërbimi konsiderohet e vlefshme për një periudhë 10 mujore nga 01.03.2023 deri më 31.12.2023 (me mundësi vazhdimi).
2.3. Kryetari i Komunës mund të zgjasë vlefshmërinë e kontratës edhe për 6 (gjashtë muaj) pa ndryshuar kushtet e dakorduara.
Pas skadimit të kësaj periudhe ose në rast të nevojës për ndryshim të kontratës, ajo duhet të miratohet nga Kuvendi i Komunës së Novobërdës dhe Kompania.

Në nenin 2 të marrëveshjes së bashkëpunimit, afati i vlefshmërisë së marrëveshjes së bashkëpunimit ndryshohet, pra zgjatet edhe për 11 muaj të tjerë, dhe kontrata e ofrimit të shërbimeve zgjatet nga **data 01.02. 2024 deri më 31.12.2024. vjet.**

**Neni 3**

Me këtë aneks të marrëveshjes së bashkëpunimit, kontraktorët ndryshojnë dhe plotësojnë nenin. 14 ku thuhet:
14.1. Me qëllim të ruajtjes së pastërtisë dhe higjienës publike, Komuna do t'i paguajë Kompanisë për shërbimet që lidhen me:

a) Duke mirëmbajtur varrezat, sipërfaqet e gjelbra publike, parqet, rrugët dhe gjelbërimin buzë të rrugëve
b) Krasitja e pemëve dhe shkurreve dhe ujitja e tyre,
c) Mirëmbajtja e monumenteve,
d) Heqja e deponive.

14.2. Për kryerjen e shërbimeve të përcaktuara në paragrafin 14.1, Komuna është e obliguar të sigurojë mjete financiare për angazhimin e njëzet e gjashtë (26) punëtorëve në shumën bruto prej 328.15 euro për punëtor në baza mujore. Punësimi i punëtorëve do të bëhet nga Kompania në përputhje me dispozitat dhe procedurat ligjore në fuqi.

Në nenin 14.2. të Marrëveshjes së Bashkëpunimit dhe Aneksit të Marrëveshjes së Bashkëpunimit, shuma bruto e mjeteve financiare për punësimin e 26 punëtorëve është ndryshuar në 385,36 euro për punëtor në baza mujore, dhe se punëtorët tjerë të punësuar të kompanisë Ekologjia nga territori i komunës. të Novobërdës, i cili do të angazhohet për kryerjen e detyrave dhe aktiviteteve shtesë përveç detyrave themelore, në përputhje me nenin 14.1. Kontratat dhe ofrimi i shërbimeve, rritja e pagës bazë në masën 30% të pagës bazë mujore.
Komuna e Novobërdës merr përsipër që t'i transferojë mjete financiare kompanisë Ekologija për të rritur pagën bazë (pagën) në vlerë prej 30% për çdo punonjës në baza mujore, i cili do të punësohet në përputhje me nenin 14.1 të Marrëveshjes për ofrimi i shërbimeve.

**<u>Cl.14.2. me ndryshime, lexohet si më poshtë:</u>**

Për kryerjen e shërbimeve të cekura në paragrafin 14.1, Komuna është e obliguar që në baza mujore të sigurojë mjete financiare për angazhimin e njëzet e gjashtë **(26)** punëtorëve në shumën bruto prej 385.36 euro për punëtor.
Të punësuarit tjerë të kompanisë Ekologjia nga territori i komunës së Novobërdës, të cilët do të angazhohen nga kompania në punë dhe aktivitete shtesë në pajtim me nenin 14.1. Kontratat dhe ofrimi i shërbimeve, rritja e pagës bazë në masën 30% të pagës bazë mujore.
Komuna e Novobërdës merr përsipër që t'i transferojë mjete financiare kompanisë Ekologija për të rritur pagën bazë (pagën) në vlerë prej 30% për çdo punonjës në baza mujore, i cili do të punësohet në përputhje me nenin 14.1 të Marrëveshjes për ofrimi i shërbimeve.

**Neni 3**

Kontraktorët gjithashtu ndryshojnë **Aneksin C** - Menaxhimi i mbeturinave për personat fizikë dhe juridikë, subjektet afariste dhe personat juridikë, organizatat dhe institucionet në Novobërdë dhe zonat e banuara.

**Shtojca C**

**Shërbimi i menaxhimit të mbetjeve për personat fizikë dhe juridikë, subjektet afariste, organizatat dhe institucionet në Novibërdë dhe zonat e populluara**

Shërbimi i menaxhimit të mbetjeve në familje individuale dhe ndërtesa banimi

**Tabela 1**

| Nr | Kriteret e llogaritjes së përdoruesit | Cmimi | TVSH 8% | Gjithsej |
|---|---|---|---|---|
| 1. | * Familjet /<br>* ndërtesa banimi | 5.56 | 0.44 | 6 |
| 2. | * Familjet që qëndrojnë herë pas here në territorin e komunës së Novobërdës | 3.22 | 0.28 | 3.5 |

**Shënim: Komuna do të subvencionojë çdo familje individuale në vlerë prej 1.5 euro**

**Komuna e Novobërdës nuk do të subvencionojë amvisëritë që herë pas here qëndrojnë në territorin e komunës së Novobërdës.**

**Tabela 2 - Shërbimi i menaxhimit të mbetjeve për subjektet dhe institucionet ekonomike**

| Nr | Llogaritja e sipërfaqeve të përdoruesve | Cmimi | TVSH 8% | Gjithsej |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Grupi i parë i ambienteve, një kovë 120 l për zbrazje | 1.39 | 0.11 | 1.5 |
| 2 | Grupi i dytë i ambienteve 2 kova nga 120 l secila ose një nga 240 l për zbrazje | 2.78 | 0.22 | 3 |
| 3 | Grupi i tretë i ambienteve - kontejner 1.1m3 për zbrazje | 7.41 | 0.59 | 8 |
| 4 | Grupi i katërt i lokaleve - kontejner 5m3 për zbrazje (mbetje komunale) | 32.41 | 2.59 | 35 |
| 5 | Grupi i pestë i lokaleve - kontejner 7m3 për zbrazje (mbetje komunale) | 41.67 | 3.33 | 45 |

**Tabela 3- Ngarkimi dhe depozitimi i mbetjeve të rrezikshme komunale për ton**

| Nr | Përshkrimi dhe kriteret e llogaritjes së përdoruesit | Masa e vetme | Cmimi | TVSH 8% | Gjithsej |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Hedhja e mbetjeve të biodegradueshme (pa ngarkim) | m3 | 9.26 | 0.74 | 10 |
| 2 | Hedhja e mbetjeve të biodegradueshme (me ngarkim) | m3 | 18.52 | 1.48 | 20 |
| 3 | Deponimi i mbetjeve ndërtimore dhe të përziera në deponijën qendrore | t | 69.44 | 5.56 | 75 |
| 4 | Deponimi i mbetjeve ndërtimore dhe të përziera në një vendgrumbullim të përkohshëm (pa ngarkim) | m3 | 9.26 | 0.74 | 10 |

**Tabela 4- Grumbullim i jashtëzakonshëm i mbetjeve**

| **Nr** | **Përshkrimi I shërbimeve** | **Masa e vetme** | **Cmimi** | **TVSH 8%** | **Gjithsej** |
|---|---|---|---|---|---|
| 1. | Pastrim i jashtëzakonshëm i kontejnerëve të vegjël për amvisëri 120 litra për thirrje | kontejner | 4.63 | **0.37** | **5** |
| 2. | Pastrim i jashtëzakonshëm i kontejnerëve të vegjël për amvisëri 240 litra për thirrje | kontejner | 9.26 | **0.74** | 10 |
| 3. | Pastrim urgjent i kontejnerëve për amvisëri 1.1 m3 për thirrje | kontejner | 18.52 | **1.48** | **10** |

**Neni 5**

Në të gjitha aspektet e tjera, Marrëveshja e Bashkëpunimit nr. 02-736 nga 1 Mars 2023, mbetet i pandryshuar.

**Neni 6**

Aneksi është nënshkruar në 4 kopje identike, 2 për secilën palë kontraktuese.

Data: _______________

Bostanë Novobërdë

për JKP „Ekologija"

Dejan Dimitrijevic, drejtor

Nënshkrimi _______________

Për Komuna Novobërdës

Sasa Milosevic, Kryetar

Nënshkrimi: ____________________